



VENDIM
Nr. 17, datë 10.3.2016

**PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT PËR
VITIN 2016, PËR DISA PROJEKTE NË
VAZHDIM, TË GRANTIT “UJËSJELLËS-
KANALIZIME”, PROGRAMI I
ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS
VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim me cikël financimi 2015–2016, për grantin “Ujësjiellës-kanalizime”, Programi i Zhvillimit Vendor dhe Rajonal, shtylla I, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Transportit dhe Infrastrukturrës dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetari
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturrës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar;

Tabela 1. Lista e projekteve me cikël financimi 2015-2016, financuar përmes grantit të ujësjiellës-kanalizimeve, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, financimi për vitin 2016.

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e projektit (në Lekë)	Vlera e kontratës (në Lekë)	Vlera e realizuar për vitin 2015 (Në Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në Lekë)
1	Bashkia Sarandë	Zëvendësimi i tubacionit të ujësjiellës nga stacioni i pompimit Vriun deri në rezervuarin e qytetit	172,448,000	126,531,839	34,435,200	92,096,639
2	Bashkia Sarandë	Përmirësimi i rrjetit të ujërave të zeza, zona Hotel Butrinti deri tek kanali Çukës	152,160,000	144,635,154	29,961,960	114,673,194
3	Bashkia Finiq	Ndërtimi ujësjiellës Navaricë - Memoraq – Dermis, Komuna Dhivër	62,262,250	62,262,250	0	43,230,167
TOTALI			386,870,250	333,429,243	64,397,160	250,000,000

Shënim:

- "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me Vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
- "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, dhe "korrekton" vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturrës).
- "Vlera e realizuar për vitin 2015" tregon vlerën e alokuar për vitin 2015, deri në 31.12.2015. Vlera e realizuar përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturrës).
- "Vlera e financimit për vitin 2016", tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së realizuar për vitin 2015.